



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1454/1 prot.,

Datë 09.06.2025

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Arteo 2018” SHPK në procedurën e prokurimit “*E hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me nr. REF- 43742-04-04-2025, me objekt: “*Blerje materiale elektrike per ndricim ne rruget e territorit te Bashkise Divjake*”, me fond limit 16.666.614 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 07.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Divjake.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Arteo 2018” SHPK me NUIS L82523203F dhe adresë: Lagjia Luigj Gurakuqi, Bulevardi Aqif Pasha, Hotel Skampa, kati 5 nr.303, Elbasan.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Divjake, me adresë: Lagjia nr.2, Divjakë

Në datën 05.06.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik, me nr. A/2025/5385, protokolluar me nr.1454/2025 prot, datë 05.06.2025, i operatorit ekonomik “Arteo 2018” SHPK, për procedurën e prokurimit prokurimit “*E hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me nr. REF- 43742-04-04-2025, me objekt: “*Blerje materiale elektrike per ndricim ne rruget e territorit te Bashkise Divjake*”, me fond limit 16.666.614 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 07.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Divjake.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Arteo 2018” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Arteo 2018” SHPK.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit të tij nga KVO-ja, si më poshtë vijon:

Operatori Ekonomik “ARTEO 2018” SHPK me NIPT L82523203F, nuk plotëson pikën 2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë katalog/katalogje ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve për zërat e mallrave të kërkuar, me të dhënat teknike, ku të jenë të përcaktuar zërat e mallrave dhe specifikimet teknike të tyre (të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar), ku të vërtetojë përputhjen e plotë të mallrave që ofron me specifikimet teknike të kërkuara. Pjesët e katalogut/katalogjeve ku tregohen produktet e ofertuara me specifikimet teknike, duhet të jenë të përkthyer në shqip, si edhe të noterizuara. Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin. Gjithashtu sygjerohet të evidentoni (markoni) në këta katalogë, specifikimet teknike për mallrat e ofruara nga ana juaj, të cilat përputhen me specifikimet e kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentet e tenderit.

Publikuar në rregjistrin e ankesave me datë 09.06.2025

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri